



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KRYETARI

Nr. __ Prot.

Date 13.7.2020

-PLAN VEPRIMI-
“PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË KONTROLLIT TË LARTË TË SHPETIT”

<u>Nr.</u>	<u>Rekomandim nga KLSH-ia</u>	<u>Nësia që ngarkohet për zbatim</u>	<u>Afati për zbatim</u>	<u>Pranohet</u>	<u>Koment</u>
<u>I.</u>	<u>MASA ORGANIZATIVE:</u>				
1	Kryetari i Bashkisë Roskovec, si dhe komisionet e inventarizimit përkatës, të marrin masat përkatëse për mbylljen e procedurave të inventarizimit vjetor brenda vitit ushtrimor, me qëllim që rezultatet e inventarizimit të pasqyrohen drejt dhe në kohë në llogaritë e pasqyrave financiare që lidhen me procesin e inventarit. Për diferencat eventuale të konstatuara nga inventarizimi, të nxirren përgjegjësitë përkatëse dhe të procedohet sipas krahutit rregullator në fuqi për sistemin e llogarive kontabël, duke nxjerrë në kohë aktet e nevojshme administrative.	Komisionet e inventarizimit të aseteve të ngritur me Urdhër të brendshëm të Kryetares.	Në vijimësi	PO	-

2	<p>Kryetari i Bashkisë Roskovec të analizojë cilat janë shkaqet e mos likuidimit të vlerës 15,703,367 lekë, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së punimeve për 25 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim. Nga Titullari dhe Drejtori Ekonomik të merren masa për likuidimin e vlerës së mësipërme, por duke analizuar më parë gjendjen nëse është përmbyllur garancia e defekteve të punimeve dhe nëse janë bërë korrigjimet e punimeve për çdo kontratë së cilës nuk i është likuiduar kjo garanci. Nëse ka defekte dhe mos realizime të punimeve, atëherë kjo vlerë nuk duhet të likuidohet.</p>	Drejtorja e Financës	Brenda datës 30.09.2020	PO	..
3	<p>Drejtorja e Financës të marrë masat për organizimin e mbajtjen e kontabilitetit sipas kërkesave ligjore duke kontabilizuar të drejtat dhe detyrimet ndaj të tretëve në momentin e konstatimit. Të merren masa për shlyerjen në kohë të detyrimeve kreditore, në zbatim të kërkesave ligjore, në mënyrë që këto detyrime të mos mbarten nga njëri vit në tjetrin, duke krijuar vështirësi financiare për njësinë vendore.</p>	Drejtorja e Financës	Menjërherë dhe në vijimësi	PO	
4	<p>Drejtorja e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve, të marrë masat e nevojshme për përgatitjen e dokumentacionit e nevojshëm teknik dhe financiar për të gjitha asetet që janë transferuar nga Bashkia Roskovec në Njësitë Vartëse.</p>	Drejtorja e Financës, Drejtorja e Shërbimeve	Brenda datës 31.07.2020	PO	

<p>5. Kryetari i Bashkisë Roskovec, të marrë masat që me specialiste të fushës, të inventarizojë dhe saktësojë pronat sipas të dhënave të kontabilitetit, të hartohet regjistri kontabël këtyre pronave me të gjitha të dhënat e nevojshme(vendndodhje, sipërfaqja etj). Në vijim të këtyre veprimeve të merren masa për regjistrimin e këtyre asetëve në Agjencinë Shtetërore të Kadashtës (ASHK).</p>	<p>Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit</p>	<p>Brenda datës 31.12.2020</p>	<p>PO</p>	
<p>6. Drejtoria e Financës ,në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve , të rakordojnë midis tyre për të saktësuar objektet për të cilat ka përfunduar investimi sipas kontratës të lidhur me sipërmarrësit dhe mbi bazën e këtij akti rakordimi , të kryejë veprimet e nevojshme kontabël për sisteminin e llogarisë 231 "Shpenzime në process për rritjen e Aktiveve të Qëndrueshme të <i>trupëzuara</i>" duke e kredituar në debi të llogarive aktive të investuara.</p>	<p>Drejtoria e Financës , Sektori i Zbatueshmërisë së Investimeve</p>	<p>Brenda datës 31.12.2020</p>	<p>PO</p>	
<p>7 Nga Kryetari i Bashkisë Roskovec të analizohet situata e detyrimeve të prapambetura dhe të nxirren përgjegjësitë për këtë situatë. Të mos merren angazhime të reja buxhetore (shpenzime të reja), pa paguar detyrimet e prapambetura, si dhe në vazhdim të mos krijohen detyrimeve të reja të prapambetura. Kjo të realizohet duke mos marrë angazhime buxhetore, pa pasur fonde në dispozicion në llogarinë e thesarit. Për detyrimet e parapambetura, të hartohet një grafik për likuidimin e tyre, duke zbatuar radhën e pagesave sipas kronologjisë së tyre. Të paraqitet në mbledhjen e Këshillit Bashkiak , një material për gjendjen e faturave të palikuiduara si dhe planin për likuidimin e tyre.</p>	<p>Drejtoria e Financës</p>	<p>Në mbledhjen më të afërte të Këshillit Bashkiak</p>	<p>PO</p>	

8	<p>Planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore si dhe nga burimet e tjera të bëhet i studiuar dhe mbi parashikime realiste. Për këtë të merren në konsideratë realizimi i të ardhurave faktike të vitit të mëparshëm, të ardhurave që do të realizohen nga arkëtimi i debitorëve (duke përfshirë debitorët "e pa shpresë", me afat debie mbi 18 muaj). Për burimet e parashikuara, prej të cilave deri në gjashtëmuajorin e parë të vitit nuk janë realizuar të ardhura, nga Kryetari i Bashkisë duhet të rishikohet planifikimi për këto burime, duke e cuar vlerën e tyre në një vlerë realisht të prishme e të realizueshme. Po ashtu të bëhet korigjimi edhe të shpenzimit.</p>	Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e të Ardhurave Vendore	Në vijimësi	PO	
9	<p>Nga Titullari i Bashkisë Roskovec, të merren masa për njohtjen dhe menaxhimin nga stafi i ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për hartimin dhe miratimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Të sigurojë programe kompjuterike të licensuara në shërbim të njësisë. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga menaxherët të programeve për realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakti. Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.</p>	Sekretari i Përgjithshëm	Menjherë dhe në vijimësi	PO	

10	<p>Nga Bashkia Roskovec, të merren masa për certifikimin dhe trajnimin e 2 audituesve të rinj, për rritjen e aftësisë profesionale të tyre. Të sigurohet realizimi i planit vjetor të auditimeve, dhe kur është e nevojshme të kryhen ndryshime të argumentuara për realizimin e funksionit të NJAB. Nga NJAB të realizohen të gjitha proceset në të gjitha fazat e auditimit në përputhje me MAB. Në raportet e auditimit të kryhen teste substanciale dhe analitike, në mënyrë që në fushat me risk të lartë auditimet të jenë të thelhura, duke evidentuar mangësitë e sistemeve të kontrollit nëpërmjet formulimit të qartë të gjejeve, përcaktimit të përgjegjësiive si dhe formulimit konkret të rekomandimeve. NJAB të kryejë vlerësimin e brendshëm të cilësisë nëpërmjet procesit të vëtvëlërësimit periodik. Të planifikohet dhe realizohet program angazhimi për ndjekjen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e brendshme. Veprimat e auditimit të brendshëm të funksionojë si veprimtari që mbështet menaxhimin e kësaj njësie vendore për arritjen e objektivave, duke ofruar siguri objektive dhe kështu për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime, që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë.</p>	<p>Sektori i Auditit të Brendshëm Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore</p>	<p>Menjherë dhe në vijimësi</p>	<p>PO</p>	
----	---	---	---------------------------------	-----------	--

11	<p>Nga Kryetari i Bashkisë Roskovec, të hartohen rregulla të shktruara për veprimet që kryhen nga punonjësi dhe strukturat përkatëse të kësaj njësie gjatë marrjes dhe dorëzimit të detyrës. Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerezore, Drejtoria e Financës, të marrin të gjitha masat e nevojshme që përpara largimit nga puna, punonjësi të bëjë dorëzimin e plotë të dokumentacionit fizik dhe elektronik që ka për shkak të detyrës, si dhe të inventarit fizik në ngarkim, sipas kartelës përkatëse për këtë qëllim.</p>	Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerezore, Drejtoria e Financës,		Brenda datës 31.08.2020	PO	
12	<p>Titullari i njësisë vendore të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore , të nxjerr arsyet dhe përgjegjësitë për humbjen e tyre dhe efektin negativ që këto vendime kanë dhënë në buxhetin e njësisë vendore. Drejtoria Juridike të ndjek proceset në të gjitha shkallët e gjyqimit, duke bërë edhe rekurs. Në rastet e largimeve të punonjësve nga puna, nga sektori juridik dhe titullari të zbatohen të gjitha procedurat e nevojshme të afateve të njoftimit dhe të pagesave të duhura, me qëllim që të ulët risku i humbjes së proceseve gjyqësore. Përpara zbatimit të vendimit gjyqësor Titullari të nxjerrë përgjegjësitë administrative, si dhe aktin që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi.</p>	Sekretari i Përgjithshëm Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerezore		Menjëherë dhe në vijimësi	PO	
II.	<p>MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR, PËR TË RRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTMIN E TË ARDHURAVE TË MUNGUARA:</p>					
1.	Drejtoria Ekonomike të marrë masa për kontabilizimin e vlerës së plotë të debitorëve, duke pasqyruar në bilanc vlerën progresive të debisë për të gjithë llojet e detyrimeve. Kryetari i Bashkisë	Drejtoria e të ardhurave vendore, Drejtoria e Financës		Brenda datës 30.09.2020	PO	

<p>dhe Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, bazuar nënenin 70 pika 3 "E drejta për të nxjerrë njoftimin e vleresimit tatimor", të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, <i>për të gjitha subjektet private të nxjerrë njoftim vlerësimit tatimor dhe në vazhdim të merren masat për arketimin e këtij detyrimi, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:</i></p> <p>a- Iu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore RSH".</p> <p>b- Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës sigurorese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91, të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH"</p> <p>c- Për subjektet të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre të aplikohet llogaritja e gjobës në masën 0.06% të shumës së detyrimit të papaguar për cdo ditë gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo më shumë se 365 ditë (gjobë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat tatimore në RSH", të ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 15.12.2014.</p> <p>d- Në rast se bizneset private dhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masa administrativë apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazur në Kodin Penal të RSH, miratuar me ligjin nr.7895, date 27.01.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 "Mospagimi i</p>				
--	--	--	--	--

	<p>taksave dhe tatimeve". e-Për debitorët familjar , në zbatim të udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr.01 date 17.01.2019 "Për zbatimin e buxhetit te vitit 2019", pika 98 , te njoftojë nëpërmjet postës familjarët të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës, të ndërtesave dhe tarifat familjare dhe të realizojë arkëtimin e detyrimit.</p>					
<p>III.</p>	<p>MASA DISIPLINORE:</p>					
<p>2.</p>	<p>Kryetari i Bashkisë Roskovec të analizojë dhe ndajë përgjegjësitë për të gjithë personat që bëhen me përgjegjësi nga ky audium, mbështetur në Vendimin dhe në Raportin Përfundimtar të Auditimit , mbi bazën e performancës së gjithsecilit të aplikojë dhënien e masave disiplinore. Masat disiplinore për punonjësit të cilët janë me status të nëpunësit civil të bazohen në nenin 58, "llojet e masave disiplinore", të ligjit nr.152/2013 datë30.05.2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar me ligjin nr.178/2014, datë 18.12.2014, ndërsa për punonjësit me kontratë, në nenet 37 dhe 144 të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe në kontratën individuale të punës. Për punonjësit të cilët do të jepet masë disiplinore, Bashkia Roskovec, Njësia e Burimeve Njerëzore, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecursë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore të ndërmarrë</p>	<p>Zëvendëskryetarët, Sekretari i Përgjithshëm</p>		<p>Në vijimësi</p>	<p>PO</p>	

<p>veprimet si më poshtë:</p> <p>a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.</p> <p>b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.</p>					
--	--	--	--	--	--

Konceptoi: E. Gishto

Sasia e ekzemplarëve të shypur: 2 (dy)



K R I J E T A R
Majlinda Buhi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA EKONOMIKE

3245
Nr. _____ prot

Roskovec, më 06.07.2020

Lënda: Plan masash i Drejtorisë Ekonomike për gjetjet dhe rekomandimet të Raportit
Perfundimtar të KLSH

KRYETARES SE BASHKISE Znj.Majlinda BUFI

Bazuar në Raportin Perfundimtar të grupit të auditimit mbi kontrollin e ushtruar në bashkinë
tëne për periudhën 01.01.2017-31.03.2020, në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet nga ky
kontroll, po ju paraqesim planin e masave me karakter organizativ për përmbushjen e këtyre
rekomandimeve për Drejtorinë Ekonomike:

1. Në lidhje me Gjetje nga auditimi 1 mbi inventarin fizik i Aktiveve të Qëndrueshme të
patrupëzuara/ të trupëzuara dhe qarkulluese për periudhën 2017,2018,2019 në të cilin
rekomandohej: "Kryetari i Bashkisë Roskovec si dhe komisionet e inventarizimit përkatës, të
marrë masa për mbylljen e procedurave të inventarizimit, brenda vitit ushtrimor.

Për diferencat eventuale të konstatuara nga inventarizimi, të nxirren përgjegjësitë përkatëse
dhe të procedohet sipas ligjit për sistemimin e llogarive kontabël duke nxjerë në kohë aktet e
nevojshme administrative", rekomandim i cili është lënë për tu realizuar **ne vijimesi**.

*Ne si drejtori duke filluar që me inventarizimin e vitit 2020 për pjesën që na takon, do të
organizojmë punën në mënyrë të tillë që si inventarizimi dhe rezultatet që rrjedhin nga ky të
përfundojnë brenda viti ushtrimor përkatës duke nxjerë në kohë aktet përkatëse
administrative.*

2. Në lidhje me Gjetje nga auditimi 2 mbi gjendjen e llogarive 466 "Kreditore për mjete në
ruajtje" dhe masat që duhen marrë mbi shlyerjen e kësaj llogarie për fondet e ngurtësuar dhe
që është përmbushur afati i garancisë dhe nuk është bërë bllokimi i tyre, për të cilin
rekomandohej që "Kryetari i bashkisë të analizoj për shkaqet e moslikuidimit të vlerës prej
15,703,367 leke e cila përfaqëson vlerën e garancisë së punimeve për 25 objekte të
përfunduara dhe që nga Kryetari i bashkisë dhe Drejtoria Ekonomike të meren masa për
likuidimin e vlerës së mesipërme duke analizuar me parë gjendjen nëse është mbyllur
garancia e defekteve të punimeve", për zbatimin e këtij rekomandimi është lënë afati i
zbatimit 30.09.2020.

*Mendojmë që për zbatimin e këtij rekomandimi duhet që Zyra e Sherbimeve gjatë
periudhës së garancisë të bëjë ndjekjen e ecurisë së punimeve dhe rregullimin në kohë të
defekteve të ndodhura dhe në bashkëpunim me komisionin e marrjes në dorezim,*

supervizoret e objekteve si dhe sipermarsit e tyre me te perfunduar afati i garancise se defekteve per punimet e kryera, te perfundojne brenda afatit te marjen ne dorezim te punimeve bazuar ne kontratat e lidhura ne dhe paraqitjen per likujdim ne Drejtorine Ekonomike per likujdim te vleres se garancise sipas procedurave te thesarit .

3. Ne lidhje me Gjetje nga auditimi 3 mbi detyrimet kreditore per vitet 2017,2018,2019 ,per te cilen **rekomandohej " Drejtoria e Financës, të marrë masat për organizimin e mbajtjen e kontabilitetit sipas kërkesave ligjore duke kontabilizuar të drejtat dhe detyrimet ndaj të tretëve në momentin e konstatimit. Të merren masa për shlyerjen në kohë të detyrimeve kreditore, në përmbushje të detyrimeve ligjore , ne menyre qe keto detyrime te mosmbarten nga njeri vite ne tjetrin , duke krijuar veshtiresi financiare per njesine vendore" ,** ku si afat eshte percaktuar **menjehere dhe ne vazhdimesi , mendojme qe te mos meren angazhime buxhetore te reja pa bere me pare shlyerjen e detyrimeve te mbartura kryesisht nga vitet 2018 dhe 2019 dhe ne si drejtori do te insistojme qe te minimizojme keto detyrime pervec qe te kontabilizohen ne kohe por dhe ne mos krijimin e detyrimeve te reja.**

4. Ne lidhje Gjetje nga auditimi 4 mbi transferimin e Aktive të Qëndrueshme për Njësitë vartëse të saj per te cilen **rekomandohet "Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve, të marrë masat, të përgatisë dokumentacionin e nevojshëm teknik dhe financiar per te gjitha asetete qe jane transferuar nga B.Roskovec Njësive Vartëse .Te percaktohet vlera perkatese kontabile per asetet e transferuara si dhe te hartohen proces-verbalet e dorezimit dhe e marjes ne dorezim per keto asetete..... "** ku si afat eshte vendosur data **31.07.2020 , mendojme qe brenda ketij afati drejtoria jone ne bashkepunim me sektorin e sherbimeve te bashkise te pregatisim dokumentacionin sipas kerkesave te mesiperme.**

5. Ne lidhje Gjetje nga auditimi 5 mbi administrimin e gjithë aktiveve afatgjata materjale dhe jomaterjale **ku rekomandohet :"** Kryetari i Bashkisë Roskovec, të marrë masat që me specialistë të fushës, të inventarizojë dhe saktësojë pronat sipas të dhënave të kontabilitetit, te hartohet regjistri kontabel i ketyre pronave me te dhenat e nevojshme (vendndodhje , siperfaqe etj.). Ne vijim te ketyre veprimeve te neren masa per regjistrimin e tyre ne ASHK", dhe si afat eshte lene data **31.12.2020.**

Mendojme qe te meren keto masa:

- Nga ana e titullarit te ngrihet nje komisjon me specialist te fushes per saktesimin dhe inventarizimin e ketyre pronave sipas te dhenave te kontabilitetit.
- Te emerohet nje punonjes ne rolin e nepunesit zbatues per mbajtjen e regjistrimit te pronave.
- Nga sektori perkates per regjistrimin e pronave prane drejtorise se Planifikimit , Zhvillimit te Teritorit dhe Urbanistikes te pershejtohet puna per regjistrimin e pronave ne ASHK si per ato qe kane kaluar ne administrim me VKM ashtu dhe ato te investuara nga bashkia.

6. Ne lidhje Gjetje nga auditimi 6 mbi analizen e llogarise 231"Shpenzime ne proces per ritjen e aktiveve te qendrueshme te trupezuara ku **rekomandohet "Drejtoria e Finances ne bashkepunim me Drejtorine e Sherbimeve , te rakordojne midis tyre per te saktesuuar objektet per te cilat ka perfunduar investimi sipas kontrates se lidhur me sipermarsit dhe mbi bazen e ketij rakordimi te kryej veprimet e nevojshme kontabel.... "** ku si afat eshte lene **31.12.2020.** **Ne si drejtori mendojme qe kjo ka te beje me zbatimin e afateve te marjes ne dorezim perfundimtar te objekteve te investuara nga zyra e sherbimeve , drejtuesit e punimeve dhe sipermarsit e punimeve sipas afateve te percaktuara ne kontratat respektive te lidhura .**

7. Ne lidhje Gjetje nga auditimi 7 , mbi detyrimet e prapambetura te krijuara , ku **rekomandohet " Nga Kryetari i Bashkise te analizohet situata dhe te nxiren pergjegjesite per**

kete situatë .Te mosmeren angazhime te reja buxhetore (Shpenzime te reja), pa paguar detyrimet e prapambetura , si dhe ne vazhdim te mos krijohen detyrime te reja te prapambetura.Kjo te realizohet duke mosmare angazhime buxhetore pa pasur fonde ne llogarine e thesarit.Per detyrimet e prapambetura te hartohet nje grafik per likuidimin e tyre duke zbatuar radhen e pageses sipas kronologjise se tyre....." .

Ne si drejtori mendojme marjen e ketyre masave dhe veprimeve:

- Mosmarjen e angazhimeve te reja buxhetore (lidhjen e kontratave te reja)per periudhen ne vazhdim deri ne shlyerjen e detyrimeve te prapambetura.
- Duke filluar nga viti buxhetor 2021 e ne vazhdim , planifikimi sa me real i te ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore duke u mbështetur dhe ne realizimin e te ardhurave te viteve te mëparshme.
- Mosnderhyrje me ndryshime buxheti gjate vitit me transferime fondesh , por kjo te behet e studiuar dhe e kushtezuar nga realizimi i te ardhurave te periudhes aktuale.
- Vendosja e nje regjimi te repte dhe kontroll i kryerjes se shpenzimeve sidomos ato korente (shpenzime personeli dhe operative dhe te mirëmbajtjes).

Per gjetjet dhe rekomandimet e tjera te KLSH jemi te hapur te bashkepunojme me drejtorit e tjera te ngarkuara per realizimin dhe zbatimin e tyre.

DREJTORI EKONOMIK

Selman CEPELE





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA E TË ARDHURAVE VENDORE

Nr. 3246 prot.

Roskovec, më 06.07 2020

Lënda: Plan masash ne lidhje me rekomandimet per auditimin financiar te ushtruar ne bashkine Roskovec nga Kontrolli i Larte i Shtetit.

KRYETARES SE BASHKISE

Roskovec

Bazuar ne Raportin perfundimtar dhe Rekomandimet nga Kontrolli i Larte i Shtetit me nr.261/7 prot. date 29.06.2020 ne lidhje me **gjetjet e pikes 8** nga auditimi ne lidhje me diferencat e dukshme midis planifikimit dhe realizimit te te ardhurave

Drejtoria e te ardhurave vendore ne lidhje me planifikime e te ardhurave per vitet e ardhshme do te beje planifikim bazuar ne realizimet e faktike.

Ne lidhje me Piken D . MASA PER ULJEN E BORXHIT TATIMOR PER TE RRIATUR PERFORMANCEN.....

1. Gjetje nga auditimi ne lidhje me detyrimet e prapabetuar me 31.12.2019 ne vleren 111.865 mije leke nga keto 14030 mije leke jane detyrime nga taksapaguesit private dhe 97835 mije leke jane detyrim nga taksapaguesit familjare

Per mbledhjen e detyrimeve te prapambetura per subjektet private ne vleren 14030 mije leke edhe pse eshte derguar njoftim detyrimi per taksat e parapambetura , eshte aplikuar kamatvonese ,urdher bllokimi llogari ,kerkese per mase hipotekore dhe siguruese :

- 1.Do tju dergohet rinjoftim per detyrimet e prapambetura subjekteve debitore
- 2.Udher bllokim llogarie bankave te nivelit te dyte
- 3.Do vendoset Barre siguruese (per mjetet) prane DRT dhe barre hipotekore prane ASHK

4. Te merret mase sekuestor dhe ne vazhdim kallezim penal per subjektet debitore.

5. Per debitoret familjare do te bejme njoftime nepermjet postes familjare per debitoret te cilet nuk kane paguar detyrimet e prapambetura.

Punoi : Ditmira Dhima

Donika Goga

